

KËRKESË
Nr. 4245/10, datë 16.11.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Kulturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Muzeu Hebraik Shqiptar në Vlorë”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në vendim nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në DRTK Vlorë si dhe në Ministrinë e Kulturës.

Ernest Sefedin Tozaj: 3,241,873.3 (tre milionë e dyqind e dyzet e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre pikë tre lekë) dhe për shtetasin Gjergji Korabi, në vlerën 3,495,489.3 (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë pikë tre lekë).

Vlera totale paraprake të shpronësimit: 6,737,362.6 (gjashtë milionë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy pikë gjashtë lekë).

ZËVENDËSMINISTËR I KULTURËS
Meri Kumbe

